

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Etiketimi i qeseve dhe kontenierëve të mbetjeve spitalore

Në pjesën e jashtme të kontenierit, qeses, duhet etiketë me përmasat 75mm x 75mm, dhe simbolin e Biohazardit me përmasa 40/75/150mm dhe 40/75/150mm.

Përmasat e Etiketës – Foto më poshtë

Simboli në Etiketë – Foto më poshtë



Specifikimet e simbolit – **ngjyra:** konturet të jenë të zeza, **fusha:** e bardhë ose ngjyra parësore e kontenierit, **fjalët dhe karakteret** të jenë të zeza, si dhe **shenja e biohazardit** të jetë e zezë dhe me lartësi minimale 30mm. Lartësia e fjalëve në anglisht, minimumi 5mm. Lartësia e karaktereve shqip, minimum 7mm.

Operatori Ekonomik, duhet të sigurojë dhe tabelën e ndarjes së mbetjeve spitalore me informacionin përkatës, referuar katalogut të ndarjes së mbetjeve spitalore, mbështetur në legjislacionin përkatës, për cdo shërbim mjekësor që prodhon mbetje.

Specifikimet teknike të vecanta të materialeve të mbetjeve të rrezikshme spitalore:

- 1. Qese ngjyrë e zezë profesionale për përdorim spitalor me përmasa 120x80cm, kapacitet mbajtës minimum 15kg.** Rezistente ndaj temperaturës deri 50 °C.
- 2. Çantë (qese), ngjyrë të verdhë,** për mbetjet e rrezikshme spitalore **me logo QSUT** me përmasa 52 x 64 cm, kapacitet mbajtës minimumi 50 litra , materiali polietilen dhe polipropilen, me një trashësi dyshtresore jo më të vogël se 80 mikron (material PE densitet të ulët) ose 75 (material PE densitet të lartë). Të jetë e shënuar me vijë të dukshme horizontale, **“KUJDES - Mos e mbushni mbi vijë”** (mbushje max 80% të qeses). Me etiketë që mund të shkruhet me bojë që nuk fshihet dhe të ngjitet në mënyrë të sigurtë. Të ketë të stampuar emblemën e rrezikut ndërkombëtar **“bio”** dhe frazën **“Kujdes! Mbetje infektive.”** (në shqip dhe anglisht). Rezistente ndaj temperaturës mbi 80 °C (80 – 135 °C), dhe lagështirës nën presion.
- 3. Kontenier i verdhë me kapak të kuq, 3 litërsh.** Madhësia 150x150x220(h)mm ose 155x155x205(h)mm, materiali HDPE. Me kapak të lëvizshëm (shtypje e lehtë) dhe me

mbyllje përfundimtare, që nuk mund të hapet pas mbylljes përfundimtare. Duhet të përmbushin standartet evropiane (p.sh.BS7320), t'i rezistojë shpimeve dhe të jetë plastike e fortë, duhet të kenë një pajisje për heqjen e ageve nga shiringa, të jetë në gjendje të trajtohet në sistemin e trajtimit me avull. E pajisur me dy doreza anësore dhe një dorezë në kapak. Duhet të përmbushin kushtet e OKB-së, me etiketë që i reziston rrezeve UV, ujit dhe të jetë ngjytëse; me etiketë 14cmx14cm në formë rombi, njoftimi rrezikut në shqip dhe anglisht.

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Qese ngjyrë e zezë profesionale për përdorim spitalor	copë	5 500
2*	Çantë (qese) ngjyrë e verdhë për mbetjet e rrezikshme spitalore	copë	30 000
3*	Kontenier i verdhë me kapak të kuq, 3 L	copë	10 000

Public Health Sector

Afatet e lëvrimit:

a) Gjysmën e sasisë së zërave të materialeve të mbetjeve të rrezikshme spitalore, operatori ekonomik duhet ta ofrojë brenda **15 (pesëmbëdhjetë) ditëve**, nga data e lidhjes së kontratës.

b) Gjysma e sasive të tjera të materialeve të mbetjeve të rrezikshme spitalore sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.

❖ Për artikujt e shënuar me asterisko ditën e Hapjes së Tenderit **datë 03.02.2017 ora 10:00** të paraqiten mostra pranë Qendrës Universitare Nënë Tereza